

Albanska

SHËNDETI PËR PRINDËRIT DHE FËMIJËT/QENDRA
SHËNDETESORE E FËMIJËVE

MIRË SE VINI TE

Vizita 3-vjeçare!



Përrshëndetje adult!

Në vizitën 3-vjeçare, do të takoni një infermiere dhe një mjek. Siç është bërë më parë, do të ndjekim shëndetin, rritjen dhe zhvillimin e fëmijës suaj. Ndonjëherë mjeku sheh penisin dhe vaginën dhe do ta prekë. Gjithashtu do të kemi mundësinë për të bërë disa pyetje lidhur me të folurin e fëmijës dhe mënyrën si është zhvilluar. Vizita pritet të zgjatë të paktën 30 minuta.

Do t'ju dërgojmë një pyetësor që t'i përgjigjeni. Merreni formularin me vete kur të vini. Jeni ju si prind që dini më shumë për fëmijën tuaj, ndaj gjatë vizitës sigurisht mund të bëni të gjitha pyetjet që doni. Për shembull, pyetjet lidhur me prindërimin, shëndetin dhe zhvillimin e fëmijës, gjumi, ushqimin, vajtjen në banjë dhe mirëqenien tuaj si prind.

Fëmijëve u pëlqen të dinë se çfarë do të ndohdë, njëlloj si ne të rriturve. Me ndihmën e kësaj dosjeje, mund ta përgatitni fëmijën tuaj duke i treguar për vizitën dhe se me çfarë do të përballet fëmija.

Gjithashtu do t'ju jepet mundësia të shkoni në një qendër shëndetësore kur fëmija të bëhet 4 dhe 5 vjeç.



Skani kodin QR ose vizitoni faqen e internetit 1177.se/jamtland-harjedalen/barn. Aty gjenden fakte dhe këshilla lidhur shëndetin, zhvillimin, të drejtat dhe kujdesin për fëmijët. Gjithashtu mund të lexohen informacione për prindërimin.



Përrshëndetje fëmijë!

Tani është momenti për vizitën 3-vjeçare në qendrën shëndetësore të fëmijëve. Në këtë vizitë, ju dhe prindi ose prindërit tuaj do të takoheni me një infermiere dhe një mjek.

Ja se çfarë do të bëni gjatë vizitës:

Do të mateni dhe do të peshoheni për të parë se sa jeni rritur që nga vizita e fundit.



Kërce mbi të gjithë tabanin e këmbës dhe kërce lart e poshtë



Vizato



Gjuaj një top



Shiko figurat



Luaj



Merr një lodër për të luajtur



Mjeku ju ekzaminon

Dëgjon zemrën dhe mushkëritë



Do të shohë dhëmbët dhe gojën



Do të shohë brenda veshëve tuaj



Ndjen me butësi barkun



Ndonjëherë mjeku sheh penisin dhe vagjinën,
dhe do t'i prekë.

Nëse keni ndonjë pyetje para vizitës,
ju lutemi të kontaktoni qendrën
shëndetësore të fëmijëve.